



KOMPANIA RAJONALE PËR UJËSJELLËS “HIDROMORAVA”- SH.A.

**RAPORTI I PUNËS
PËR TREMUJORIN E KATËRT TË VITIT 2025**

Shkurt, 2026

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|---|----|
| FJALORI I AKRONIMEVE/SHKURTESAVE | 5 |
| 1. KRYESHEFI EKZEKUTIV | 6 |
| 1.1. Hyrje..... | 7 |
| 1.2. Aktivitetet kryesore..... | 9 |
| 1.3. Vendime dhe akte të tjera..... | 12 |
| 2. BORDI I DREJTORËVE..... | 15 |
| 2.1. Vendimet e Bordit të Drejtorëve | 15 |
| 3. KOMISIONI I AUDITIMIT | 16 |
| 3.1. Vendimet e Komisionit të Auditimit..... | 16 |
| 3.2. Përmbledhje e Raportit të Punës së Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm për periudhën e tremujorit të katërt të vitit 2025 | 16 |
| 4. ZYRA E SEKRETARES/DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV | 18 |
| 4.1. Zyra e Burimeve Njerëzore..... | 19 |
| 4.2. Zyra ligjore..... | 20 |
| 4.3. Arhiva | 21 |
| 5. DEPARTAMENTI FINANCIAR..... | 23 |
| 5.1. Aktivitetet kryesore..... | 23 |
| 5.2. Shqyrtimi i performances operative dhe financiare..... | 23 |
| 5.3. Pasqyrat Financiare | 33 |
| 5.3.1. Shpalosje e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare deri më 31 dhjetor 2025..... | 40 |
| 6. ZYRA E PROKURIMIT | 48 |
| 7. DIVIZIONI PËR CILËSI TË UJIT | 50 |
| 7.1. Cilësia e ujit | 50 |
| 8. DEPARTAMENTI TEKNIK..... | 53 |
| 8.1 Aktivitetet kryesore të drejtorit teknik | 53 |
| 8.2 Divizioni për Prodhimin e Ujit dhe Stacionet e Pompimit..... | 56 |
| 8.2.3. Sasia e ujit të prodhuar, ujit të faturuar dhe humbjeve të ujit | 58 |
| 8.3 Mirëmbajtja e Rrjetit të Ujësjellësit | 61 |
| 8.4. Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit | 65 |
| 8.5 Divizioni për planifikim dhe menaxhim të projekteve | 66 |

TABELAT

| | |
|---|----|
| Tabela 1. Takimet e Kryeshefit Ekzekutiv me institucionet dhe organizatat relevante gjatë periudhës TM4/2025 | 9 |
| Tabela 2. Vendimet e Kryeshefit Ekzekutiv gjatë periudhës TM4/2025 | 12 |
| Tabela 3. Numri i të punësuarve në njësitë punuese gjatë periudhës së TM4/2025 | 19 |
| Tabela 4. Struktura gjinore e të punësuarve gjatë periudhës së TM4/2025 | 19 |
| Tabela 5. Lëndët e pranura nga Gjykatat kompetente gjatë periudhës së TM4/2025 | 20 |
| Tabela 6. Numri i dokumenteve të protokolluara sipas njësive gjatë periudhës së TM4/2025 | 22 |
| Tabela 7. Paraqitja grafike e prodhimit të ujit në m ³ | 23 |
| Tabela 8. Paraqitja grafike e faturimit të ujit në m ³ | 24 |
| Tabela 9. Paraqitja grafike e faturimit në euro (€) | 24 |
| Tabela 10. Paraqitja grafike e arkëtimit të ujit/€ | 25 |
| Tabela 11. Paraqitja grafike e përqindjes së arkëtimit | 25 |
| Tabela 12. Paraqitja grafike e shpenzimeve në euro (€) | 26 |
| Tabela 13. Raporti i performancës operative dhe financiare për regjion TM4/2025 dhe TM4/2024 dhe plani TM4/2025 | 27 |
| Tabela 14. Raporti i performancës operative dhe financiare për Njësinë Operative të Gjilanit TM4/2025 dhe krahasimi me TM4/2024 | 29 |
| Tabela 15. Raporti i performancës operative dhe financiar për Njësinë Operative të Kamenicës TM4/2025 dhe krahasimi me TM4/2024 | 30 |
| Tabela 16. Raporti i performancës operative dhe financiare për Njësinë Operative në Vitisë për TM4/2025, krahasimi me TM4/2024 | 31 |
| Tabela 17. Treguesit – të hyrat dhe shpenzimet operative për TM4/2025 dhe krahasimi me TM/2024 | 32 |
| Tabela 18. Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paranë në banka dhe në arkë | 40 |
| Tabela 19. Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat tjera | 40 |
| Tabela 20. Stoqet | 41 |
| Tabela 21. Pasuritë tjera afatshkurta | 42 |
| Tabela 22. Pronat, impiantet dhe pajisjet | 42 |
| Tabela 23. Llogaritë e pagueshme | 43 |
| Tabela 24. Detyrimet tjera afatshkurtra | 45 |
| Tabela 25. Të hyrat e shtyra /grantet | 45 |
| Tabela 26. Ekuiteti | 45 |
| Tabela 27. Të hyrat | 45 |
| Tabela 28. Shpenzimet e shpërndarjes | 46 |
| Tabela 29. Shpenzime administrative të tjera | 47 |
| Tabela 30. Fitimi (humbja) para tatimit | 46 |
| Tabela 31. Ndryshimet në ekuitet | 47 |
| Tabela 32. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë periudhës TM4/2025 – vlerë minimale | 48 |
| Tabela 33. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë periudhës TM4/2025 – “kuotim i çmimit” | 48 |
| Tabela 34. Aktivitetet e prokurimit gjatë periudhës TM4/2025 – “procedurë e hapur – vlerë e mesme” .. | 48 |
| Tabela 35. Aktivitetet e prokurimit gjatë periudhës TM4/2025 – “procedurë e hapur - kuotim i çmimit” | 49 |
| Tabela 36. Aktivitetet e prokurimit gjatë periudhës TM4/2025 – “vlerë e madhe” | 49 |

| | |
|--|----|
| Tabela 37. Takimet e Drejtorit Teknik me institucionet relevante dhe operator ekonomik, gjatë TM4/2025 | 54 |
| Tabela 38. Sasia e ujit të prodhuar, faturuar dhe ujit të pafaturuar gjatë periudhës së TM4/2025 për secilën komunë..... | 58 |
| Tabela 39. Sasia e ujit të prodhuar, faturuar dhe ujit të pafaturuar gjatë periudhës së TM4/2025 | 58 |
| Tabela 40. Zona e shërbimit, numri dhe natyra e defekteve të ndodhura gjatë periudhës së TM4/2025.... | 61 |
| Tabela 41. Analiza, prodhimi, faturimi dhe UPF, gjatë periudhës së TM4/2025 në DMA zonat për regjionin e Gjilanit..... | 64 |
| Tabela 42. Numri i intervenimeve në rrjetin e kanalizimit gjatë periudhës së TM4/2025..... | 65 |
| Tabela 43. Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit gjatë periudhës së TM4/2025 në Gjilan | 65 |
| Tabela 44. Aktivitetet e realizuara nga DPMP gjatë periudhës së TM4/2025 | 66 |

SHËNIMET SHPJEGUESE

| | |
|--|----|
| Shënimet shpjeguese 1. Paraja dhe ekuivalentët e parasë..... | 40 |
| Shënimet shpjeguese 2. Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat tjera..... | 40 |
| Shënimet shpjeguese 3. Stoqet..... | 40 |
| Shënimet shpjeguese 4. Pasuritë tjera afatshkurta | 42 |
| Shënimet shpjeguese 5. Pasuritë afatgjata – pronat, impiantet dhe pajisjet | 42 |
| Shënimet shpjeguese 6. Investimet në vijim/projektet..... | 43 |
| Shënimet shpjeguese 7. Llogaritë e pagueshme për TM4/2025 | 43 |
| Shënimet shpjeguese 8. Detyrimet tjera afatshkrutra..... | 44 |
| Shënimet shpjeguese 9. Të hyrat e shtyera/grantet | 45 |
| Shënimet shpjeguese 10. Ndryshimi në ekuitet | 45 |
| Shënimet shpjeguese 11. Të hyrat..... | 45 |
| Shënimet shpjeguese 12. Shpenzimet e shpërndarjes | 46 |
| Shënimet shpjeguese 13. Shpenzimet administrative të tjera | 46 |
| Shënimet shpjeguese 14. Fitimi (humbja) para tatimit e vitit | 46 |

| | |
|--|----|
| Tabela 37. Takimet e Drejtorit Teknik me institucionet relevante dhe operator ekonomik, gjatë TM4/2025 | 54 |
| Tabela 38. Sasia e ujit të prodhuar, faturuar dhe ujit të pafaturuar gjatë periudhës së TM4/2025 për secilën komunë..... | 58 |
| Tabela 39. Sasia e ujit të prodhuar, faturuar dhe ujit të pafaturuar gjatë periudhës së TM4/2025 | 58 |
| Tabela 40. Zona e shërbimit, numri dhe natyra e defekteve të ndodhura gjatë periudhës së TM4/2025.... | 61 |
| Tabela 41. Analiza, prodhimi, faturimi dhe UPF, gjatë periudhës së TM4/2025 në DMA zonat për regjionin e Gjilanit..... | 64 |
| Tabela 42. Numri i intervenimeve në rrjetin e kanalizimit gjatë periudhës së TM4/2025..... | 65 |
| Tabela 43. Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit gjatë periudhës së TM4/2025 në Gjilan | 65 |
| Tabela 44. Aktivitetet e realizuara nga DPMP gjatë periudhës së TM4/2025 | 66 |

SHËNIMET SHPJEGUESE

| | |
|---|----|
| Shënimet shpjeguese 1. Paraja dhe ekuivalentët e parasë..... | 40 |
| Shënimet shpjeguese 2. Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat tjera..... | 40 |
| Shënimet shpjeguese 3. Stoqet..... | 40 |
| Shënimet shpjeguese 4. Pasuritë tjera afatshkurta | 42 |
| Shënimet shpjeguese 5. Pasuritë afatgjata – pronat, impiantet dhe pajisjet..... | 42 |
| Shënimet shpjeguese 6. Investimet në vijim/projektet..... | 43 |
| Shënimet shpjeguese 7. Llogaritë e pagueshme për TM4/2025 | 43 |
| Shënimet shpjeguese 8. Detyrimet tjera afatshkrutra..... | 44 |
| Shënimet shpjeguese 9. Të hyrat e shtyera/grantet | 45 |
| Shënimet shpjeguese 10. Ndryshimi në ekuitet | 45 |
| Shënimet shpjeguese 11. Të hyrat..... | 45 |
| Shënimet shpjeguese 12. Shpenzimet e shpërndarjes | 46 |
| Shënimet shpjeguese 13. Shpenzimet administrative të tjera | 46 |
| Shënimet shpjeguese 14. Fitimi (humbja) para tatimit e vitit | 46 |

FJALORI I AKRONIMEVE/SHKURTESAVE

ARRU – Autoriteti Rregullator i Ujërave

B.I. – Biznes Individual

DMA zona – District Metered Area (Zona e Matjes së Rrjetit/Ujësjetllësit)

EBRD – European Bank for Reconstruction and Development (shqip. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim)

FLAWS – Fostering and Leveraging Opportunities for Water Security (shqip: Nxitja dhe Shfrytëzimi i Mundësive për Sigurinë Ujore)

FPU – Fabrika e Përpunimit të Ujit

GIS – Geographic Information System (Sistemi Gjeografik i Informacionit)

GOPA - Gesellschaft für Organisation, Planung und Ausbildung (Shoqëria për Organizim, Planifikim dhe Trajnim).

HM – Hidromorava

IKSHP – Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik

IMF – Institucionet mikrofinanciare

ITUN - Impianti i trajtimit të ujërave të ndotur

KESCO – Kompania për shpërndarjen e Energjisë Elektrike të Kosovës

KIWER – Kosovar Institute for Water and Environmental Research (Instituti Kosovar për Kërkime në Fushën e Ujit dhe Mjedisit)

KRU – Kompania Rajonale e Ujësjetllësit

MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

NTSh – Ndërmarrje Tregtare Shoqërore

Nj.O. – Njësi Operative e KRU Hidromorava Sh.A.

Sh.A. – Shoqëri Aksionare

ShPK – Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara

SHUKOS – Shoqata e Ujësjetllësive dhe Kanalizimeve të Kosovës

SHUKALB – Shoqata e Ujësjetllësive dhe Kanalizimeve të Shqipërisë

TVSH – Tatimi mbi vlerën e shtuar

UPF – Uji i pafaturuar

FJALORI I TERMAVE TEKNIK TË PËRDORUR

| | |
|-----------------------|--|
| Gypat AC | Gypat prej azbest/cementi |
| Gypat HDPE | Gypat prej polietileni të fortë dhe të qëndrueshëm |
| Gypat DN 80 mm | Gypat me diametër nominal 80 milimetra |
| Gypat PE | Gypat prej polietileni |

1. KRYESHEFI EKZEKUTIV

1.1. Hyrje

Ky raport i referohet periudhës raportuese të tremujorit të katërt të vitit 2025 dhe ndërlidhet me performancën aktuale financiare dhe operative të Ndërmarrjes, si dhe me përshkrimin e arritjeve të caqeve të Planit të Biznesit të KRU "Hidromorava" – Sh.A. Gjilan.

Gjatë periudhës së tremujorit të katërt të vitit 2025 Ndërmarrja ka vazhduar të përballlet me një sërë sfidash të natyrës teknike, operative dhe financiare, të cilat kanë ndikuar në menaxhimin efikas të resurseve dhe në realizimin e objektivave strategjike të përcaktuara.

- **Dalja në treg të lirë për furnizim me energji elektrike:** Sfidë e madhe për kompaninë mbetet dalja në treg të lirë për furnizim me energji nga data 1 qershor 2025, pasi që faturat e energjisë për muajt qershor – nëntor 2025 kanë ngritje mbi 100% dhe këto shpenzime nuk janë të parapara në PB 2025 si dhe nuk janë të parapara as në proces tarifar 2025 që dmth se nuk ka pas ngritje të tarifës për këtë shpenzim, pasi që edhe ARRU nuk ka pasur informata se një gjë e tillë do të ndodh në mes të vitit 2025. Ne kemi pasur disa takime me ARRU, ku të njëjtit kanë pasur takime me ZRRE me kërkesë që për ujësjellësit të ketë përjashtim nga dalja në treg të lirë, por që përgjigja e ZRRE ka qenë negative dhe se sipas ligjit edhe NP duhet ti nënshtrohen daljes në treg të lirë. Gjithashtu, ne kemi dërguar kërkesë edhe në ARRU që të ketë proces të jashtëzakonshëm për ngritje të tarifës së ujit, por që të njëjtit na kanë kthyer përgjigje zyrtare se është e pamundur të ketë një proces të jashtëzakonshëm tarifar përshkak të kohës së shkurt, si dhe ARRU në këtë kohë veç se janë duke punuar në një proces të rregullt tarifar 3 vjeçar 2026-2028. Sipas letrës së tyre, kosto më e madhe për energji që do të shpenzohet gjatë këtyre 7 muajve të vitit 2025 do të përlogaritet në procesin tarifar 2026-2028. Ky shpenzim i pa parashikuar do të ndikoj edhe në pasqyrën e të ardhurave të Kompanisë me theks të veçantë te fitimi/humbja NETO, pas zhvlerësimit dhe pas provizionimit (zëra jo material).
- **Menaxhimi i prodhimit dhe furnizimi me ujë:** Gjatë muajve të verës, një sfidë e madhe për Ndërmarrjen ka qenë furnizimi i rregullt me ujë të pijshëm për të gjithë konsumatorët, por që ia kemi dalë me sukses ti plotësojmë kërkesat e shtuara gjatë kësaj periudhe, me përjashtim të disa lagjeve që gjenden në lartësi më të madhe, ku kemi pasur mungesa të kohëpaskohshme të furnizimit. Edhe në muajin dhjetor 2025, e sidomos në gjysmën e dytë të dhjetorit kemi pas kërkesë të shtuar për furnizim me ujë, pasi që kemi pas një fluks të madh të mërgimtarëve, por që kemi arrit të kemi një furnizim shumë të mire dhe pothuajse pa ankesa nga konsumatorët.
- **Menaxhimi i humbjeve të ujit:** Mbetet një sfidë e vazhdueshme për Kompaninë dhe për të ardhë deri te rezultatet e dukshme nevojiten investime, si në rrjet të ujësjellësit, po ashtu edhe në ndërrim të ujëmatësve të vjetër, në krijimin e DMA zonave të reja, në vendosjen e pajisjeve për menaxhim të presionit etj, të cilat i kemi parapara në investime në Planin e Biznesit 2026-2028. Përveç humbjeve teknike, nevojitet një fokus i madh në humbjet komerciale, në luftimin e keqpërdoruesve të ujit përmes lidhjeve ilegale, për çka edhe kemi parapara një ekip të veçantë për këtë aktivitet, në punëtorin e fundit me Bordin e Drejtorëve, me që rast edhe i kemi parapara ndryshimet në "Rregulloren për sistematizim të

vendeve të punës”.

- **Inkasimi i borxheve të vjetra:** Mbetet sfidë e vazhdueshme pasi që kemi të bëjmë me një kategori të konsumatorëve që nuk kanë paguar për një kohë të gjatë dhe është e vështirë që të binden për pagesë, pasi që edhe ligji për marrëdhëniet detyimore e lejon parashkrimin e borxheve më të vjetra se një vit. Në këtë aspekt jemi duke e zbatuar “Planin e Veprimit” për vitin 2025 dhe përveç aktiviteteve të zakonshme kemi filluar edhe vizitat me prezencë të policisë të konsumatorëve të cilët nuk kanë lejuar shkyccjen nga rrjeti i ujësjellësit përshkak të borxheve të pa paguara.
- **Menaxhimi dhe Mirëmbajtja e Fabrikave të Prodhimit (Përlepnicë, Velekincë dhe Letnicë)** – Është një sfidë e madhe për Kompaninë, pasi që në këto fabrika pothuajse nuk është investuar fare për një kohë të gjatë, si dhe nuk ka pas mirëmbajtje të rregullt të tyre. Në fabrikën në Përlepnicë përveç që ka munguar mirëmbajtja e rregullt, nuk ka pasur as investime që nga viti 2004, në Fabrikën në Velekincë po ashtu nuk ka pasur mirëmbajtje të rregullt dhe investime që nga viti 2014 (me përjashtim të një investimi të vogël për mirëmbajtje në vlerë prej 150k nga ME gjatë vitit 2024), në Fabrikën në Letnicë gjithashtu nuk ka pasur investime e as mirëmbajtje të rregullt që nga lëshimi në punë i fabrikës në vitin 2002). Duke marr parasysh tarifat e ulëta, të ndikuara edhe nga inflacioni i 3 viteve të fundit, e në anën tjetër koston së lartë për të investuar në fabrika, ka qen pothuajse e pamundur që ky investim të bëhet me mjete vetanake deri më tani, por me ngritjen e tarifave, nga viti 2026 e tutje, duhet ti japim prioritet investimeve në fabrika me pajisje të teknologjisë së re dhe pastaj të ketë edhe mirëmbajtje të rregullt të tyre.
- **Menaxhimi i projekteve të shumta paralele:** Sfiduese mbetet edhe menaxhimi efikas i një numri të madh të projekteve – si ato të financuara nga të hyrat e Kompanisë, projektet me Ministrinë e Ekonomisë, si dhe projektet në bashkëpunim me Bankën Botërore në kuadër të programit FLOWS, i cili tashmë ka hyrë në fazën e zbatimit në terren me PAKO-n 1 dhe PAKO-n 2, si dhe projekti me EBRD dhe EIB për ITUN, ku pas nënshkrimit të dy Marrëveshjeve, asaj për ndërtim të kolektorëve në gjatësi prej 12.5 km, si dhe Kompanisë Mbikëqyrëse për mbikëqyrje të punimeve, shumë shpejt pritet edhe të fillohet me punët në terren.

Përkundër këtyre sfidave, Ndërmarrja mbetet e përkushtuar në zbatimin e masave konkrete për përmirësimin e funksionimit operativ dhe garantimin e furnizimit cilësor me ujë për të gjithë konsumatorët.

1.2. Aktivitetet kryesore

Gjatë periudhës së tremujorit të katërt të vitit 2025, krahas angazhimeve të përditshme në menaxhim të Ndërmarrjes, Kryeshefi Ekzekutiv ka mbajtur edhe takimet e listuara në tabelën më poshtë:

Tabela 1. Takimet e Kryeshefit Ekzekutiv me institucionet dhe organizatat relevante gjatë periudhës TM4/2025

| Nr. | Institucioni: | Data: | Qëllimi i takimit: |
|-----|--------------------------------|------------|---|
| 1. | EBRD | 06.10.2025 | Qëllimi i takimit ishte që të diskutohet për kërkesën e paraqitur nga Kompania Mbikëqyrëse e Projektit të ITUN, për ndryshim të disa ekspertëve, të cilët janë angazhuar në projekte tjera dhe nuk janë më ne dispozicion të Kompanisë Mbikëqyrëse. |
| 2. | FLAWS | 07.10.2025 | Takim me përfaqësuesit e FLAWS, ku prezent ishin edhe Kompania fituese e PAKO 2 si dhe Kompania Mbikëqyrëse e projektit. Në takimin fillestar është diskutuar për përgatitjet për fillimin e punimeve të PAKO-s 2 të projektit FLAWS, e cila përfshin: Zgjerimin e Fabrikës në Letnicë, Ndërrimin e gypit kryesor në Kamenicë, si dhe ndërrimin e gypit të asbestit në SP Baja. |
| 3. | Ministria e Ekonomisë - NJPMNP | 13.10.2025 | Takimi i rregullt vjetor me Aksionarin, në të cilin takim si zakonisht është diskutuar për performancën e Kompanisë për vitin 2024, raportin e Auditorit të Jashtëm, si dhe për performancën e Menaxhmentit të Kompanisë. |
| 4. | EBED | 21.10.2025 | Takim online me përfaqësuesit e EBRD, qëllimi i takimit ka qenë bashkërendimi i aktiviteteve për fillimin e punimeve në projektin e ITUN. |
| 5. | OSBE | 22.10.2025 | Takim me përfaqësuesit e OSBE, ku qëllimi i takimit ka qenë diskutimi në lidhje me borxhet e papaguara të komunitetit serb të fshatit Shillovë. Jemi dakorduar që pasi Sekretarja e Ndërmarrjes të marrë konfirmim nga ARRU dhe Gjykata Supreme se si të veprohet me këto borxhe të vjetra, të kemi edhe një takim tjetër dhe ti njoftojmë për hapat e mëtejshëm. |
| 6. | SHUKOS | 23.10.2025 | Takim i rregullt i Bordit SHUKOS, ku përveç pikave të rregullta është diskutuar edhe për ndryshim/plotësim rregulloren e ARRU për çmimet e shërbimeve, si dhe për mbarëvajtjen e |

| | | | |
|-----|--|---------------|--|
| | | | konferencës së përbashkët Ballkanike të ujërave SHUKALB/SHUKOS, e cila kësaj radhe do të mbahet në Shqipëri. |
| 7. | Qeveria e Kosovës – Zyra e Kryeministrit | 05.11.2025 | Qëllimi i takimit ishte : Të gjitha NP duhet të raportojnë në formatin e njëjtë, si dhe raportet përveç në formatin PDF të dërgohen edhe në formatin Word. Gjithashtu, si temë me shumë rëndësi ishte edhe zbatimi i rekomandimeve nga Auditori i Jashtëm, ku është kërkuar nga secila NP që ti zbatojnë së paku 50% të rekomandimeve. |
| 8. | ARRU | 10.11.2025 | Qëllimi i takimit ishte që të gjitha KRU-të të rishikojnë edhe një herë formatin e ri të procesit tarifor, si dhe të analizohet baza rregullatore për të verifikuar nëse janë të përfshira të gjitha zonat e shërbimit që janë nën menaxhimin e KRU-ve. |
| 9. | SHUKALB/SHUKOS | 11-13.11.2025 | Është mbajtur konferenca e përbashkët Ballkanike SHUKOS/SHUKALB, gjatë së cilës, përveç prezantimeve të ndryshme, pjesëmarrësit kanë pasur mundësinë të vizitojnë edhe ekspozitën e organizuar nga kompani të ndryshme që ofrojnë pajisje dhe pjesë për ujësjellës dhe kanalizim. |
| 10. | ITUN | 18.11.2025 | Qëllimi i takimit ishte sqarimi i çështjes së TVSH-së me OE-në fituese, pasi që para realizimit të porosisë së materialit duhet të specifikohet qartë se cilat mallra janë me TVSH dhe cilat pa TVSH. Kjo është e domosdoshme për shkak se kontratat e aprovuara në Kuvend me EIB dhe EBRD dallojnë, ku njëra kontratë përfshin TVSH, ndërsa tjetra jo. |
| 11. | SHUKOS – RCDN | 21.11.2025 | Qëllimi i takimit ishte pjesëmarrja në dialogun kombëtar me palët e interesit, me temën “Iniciativa e parë për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Llumit”. Ky diskutim ka shërbyer si platformë bashkërenduese për harmonizimin e vizionit të përbashkët, shqyrtimin e aspekteve ligjore, institucionale dhe financiare, si dhe për përcaktimin e hapave fillestarë drejt ndërtimit të një procesi strategjik gjithëpërfshirës, i cili do të mundësojë menaxhim të qëndrueshëm të llumit në Kosovë. |

| | | | |
|-----|--|---------------|--|
| 12. | Banka Botërore - FLOWS | 25.11.2025 | Qëllimi i takimit ishte prezantimi i lokacioneve për ndërtimin e pesë digave të reja në Kosovë, si dhe theksimi i nevojës së madhe për hartimin e një master plani të ri, duke pasur parasysh se aktualisht është ende në fuqi master plani i viteve '80. |
| 13. | SHUKOS | 01.12.2025 | Është mbajtur mbledhja e rregullt e Bordit të SHUKOS, ku, përveç pikave të zakonshme të rendit të ditës, është prezantuar edhe raporti përmbyllës i projektit RCDN – GIZ. |
| 14. | Ministria e Ekonomisë- NJPMNP | 03&04.12.2025 | NJPMNP, në bashkëpunim me IFC (International Finance Corporation – World Bank Group), ka organizuar një punëtori në fushën e Qeverisjes Korporative për të gjithë Drejtorët e Bordeve të Ndërmarrjeve Publike. Në këtë punëtori, pjesëmarrës ka qenë edhe Bordi i KRU “Hidromorava” Sh.A |
| 15. | Komuna Gjilan | 05.12.2025 | Është zhvilluar një takim me Kryetarin e Komunës Gjilan, ku janë diskutuar çështje me interes të përbashkët, të cilat synojnë të përmirësojnë përfitimet për qytetarët e komunës. |
| 16. | ITUN | 05.12.2025 | Është mbajtur **takimi i progresit për ITUN, ku nga operatori ekonomik fitues u njoftuam mbi porositë e materialeve, çështjen e TVSH-së, si dhe afatet e dorëzimit të materialeve. |
| 17. | Komuna Viti | 17.12.2025 | Është zhvilluar një takim me Kryetarin e Komunës në Viti, ku temë diskutimi kanë qenë projektet e ujësjellësit të financuara nga Komuna, të cilat, pasi të përfundojnë, do të kalojnë nën menaxhimin e KRU “Hidromorava” Sh.A. |
| 18. | Banka Botërore - FLOWS | 17.12.2025 | Janë mbajtur takimet e progresit për **PAKO-n 1** dhe **PAKO-n 2**, ku nga kompanitë fituese dhe kompania për mbikëqyrje u morën informacione mbi progresin e projektit FLOWS. |
| 19. | SHUKOS | 18.12.2025 | Është mbajtur mbledhja e rregullt e Bordit të SHUKOS, ku, përveç pikave të zakonshme të rendit të ditës, u mor vendim për anëtarësimin e SHUKOS në IWA me statusin Governing Member (anëtar qeverisës). |
| 20. | Rezilenca klimatike në sektorin e ujit | 19.12.2025 | Qëllimi i takimit ishte dakordimi dhe operacionalizimi i “Planit Afatshkurtër të |

| | | | |
|-----|---|---------------|--|
| | | | Veprimet për Zvogëlimin e UPF". Gjatë takimit u diskutua **përzgjedhja e një DMA-je reprezentative**, si dhe koordinimi i hapave të nevojshëm për fillimin e implementimit gjatë periudhës janar-qershor 2026. |
| 21. | Bordi & Menaxhmenti KRU "Hidromorava" Sh.A. | 22&23.12.2025 | Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti i KRU "Hidromorava" Sh.A ka mbajtur një punëtori, ku janë aprovuar tre rregullore, si dhe është zhvilluar Mbledhja e 12-të e Bordit të Drejtorëve. |

1.3. Vendime dhe akte të tjera

Në kudër të detyrave dhe përgjegjësi të tij, Kryeshefi Ekzekutiv gjatë periudhës së tremujorit të katërt të vitit 2025, ka nxjerrë 20 vendime të listuara si më poshtë:

Tabela 2. Vendimet e Kryeshefit Ekzekutiv gjatë periudhës TM4/2025

| Nr. | Vendimi: | Numri i Vendimit: | Data e protokollimit: |
|-----|---|-------------------|-----------------------|
| 1. | Vendim për aprovimin e pushimit pa pagesë për punëtorin R.A., e angazhuar si Zyrtare për Konsumator, në kohëzgjatje prej një muaji, në pajtim me nenin 40, paragrafi 1 të Ligjit të Punës, për arsye të gjendjes së saj shëndetësore. | 1378 | 07.10.2025 |
| 2. | Vendim për aprovimin e plotësim-ndryshimit të përbërjes së Komisionit për Shqyrtimin e Rasteve të Konsumatorëve, i cili trajton rastet e konsumatorëve që nuk gjenden, faturat e dyfishta dhe çështje të tjera të ngjashme. | 1395 | 09.10.2025 |
| 3. | Vendim për të punësuarit e KRU "Hidromorava"- SH.A, përkitazi me respektimin e orarit të punës, pushimet vjetore, pushimet mjekësore, disiplinës në punë, konform dispozitave ligjore në fuqi dhe rregulloreve të brendshme të Kompanisë. | 1413 | 14.10.2025 |
| 4. | Vendim për caktimin e Komisionit për pranimin e ujëmatësve në KRU "Hidromorava" Sh.A. | 1154 | 05.12.2025 |
| 5. | Vendim për caktimin e Komisionit për pranimin e punëve të projektit "Kuçjet individuale në fshatin Uglar, Komuna Gjilan". | 1561 | 08.12.2025 |
| 6. | Vendim për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje me shkrim" ndaj të punësuarit B.H. i sistemuar në punët dhe detyrat punuese "Lexues i ujëmatësve dhe shpërndarës i faturave" në KRU "Hidromorava" Sh.A. me rekomandim të Komisionit Disiplinor, bazuar në nenin 85. të Ligjit të Punës nr.03/L-212, si dhe nenit 4. të Rregullores për përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të të punësuarve në KRU "Hidromorava"-Sh.A.. | 1587 | 15.12.2025 |

| | | | |
|-----|---|------|------------|
| 7. | Vendim për shqiptimin e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” ndaj të punësuarit F.S. i sistemuar në punët dhe detyrat punuese “Ujëinstalues-mjeshtër” në KRU “Hidromorava” Sh.A. me rekomandim të Komisionit Disiplinor, bazuar në nenin 85. të Ligjit të Punës nr.03/L-212, si dhe nenit 4. të Rregullores për përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të të punësuarve në KRU “Hidromorava”-Sh.A. | 1588 | 15.12.2025 |
| 8. | Vendim për shqiptimin e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” ndaj të punësuarit G.M. i sistemuar në punët dhe detyrat punuese “Vozitës i makinerisë së rëndë” në KRU “Hidromorava” Sh.A. me rekomandim të Komisionit Disiplinor, bazuar në nenin 85. të Ligjit të Punës nr.03/L-212, si dhe nenit 4. të Rregullores për përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të të punësuarve në KRU “Hidromorava”-Sh.A. | 1589 | 15.12.2025 |
| 9. | Vendim për formimin e komisioneve për regjistrimin e mjeteve themelore, inventarit, depove dhe arkave, në të gjitha njësitë punuese (Gjilan, Viti dhe Kamenicë), për vitin 2025. | 1596 | 18.12.2025 |
| 10. | Vendim për shqiptimin e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” ndaj të punësuarit M.S. i sistemuar në punët dhe detyrat punuese “Lexues i ujëmatësve dhe shpërndarës i faturave” në KRU “Hidromorava” Sh.A. me rekomandim të Komisionit Disiplinor, bazuar në nenin 85. të Ligjit të Punës nr.03/L-212, si dhe nenit 4. të Rregullores për përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të të punësuarve në KRU “Hidromorava”-Sh.A. | | |
| 11. | Vendim që punonjësit Kreshnik Aliu, Shef i Divizionit për Menaxhimin e Projekteve, t’i caktohet kompensim shtesë prej 0.30 njësi të koeficientit (72.00 €) për kryerjen e detyrave të menaxhimit dhe përcjelljes së punimeve të projektit ITUN (PIU), brenda dhe jashtë orarit të punës, përfshirë edhe punën gjatë vikendeve sipas nevojës. | 1654 | 29.12.2025 |
| 12. | Vendim për formimin e Komisionit për kategorizimin e konsumatorëve, me qëllim të mbështetjes së procesit të riprogramimit të borxheve ndaj KRU “Hidromorava” Sh.A. | 1656 | 30.12.2025 |
| 13. | Vendim për caktimin e Komisionit për pranimin e punëve të projektit “Kuçjet individuale në fshatin Uglar, Komuna Gjilan”. | 1561 | 08.12.2025 |
| 14. | Vendim për shqiptimin e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” ndaj të punësuarit B.H. i sistemuar në punët dhe detyrat punuese “Lexues i ujëmatësve dhe shpërndarës i faturave” në KRU “Hidromorava” Sh.A. me rekomandim të Komisionit Disiplinor, bazuar në nenin 85. të Ligjit të Punës nr.03/L-212, si dhe nenit 4. të Rregullores për përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të të punësuarve në KRU “Hidromorava”-Sh.A.. | 1587 | 15.12.2025 |

| | | | |
|-----|---|------|------------|
| 7. | Vendim për shqiptimin e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” ndaj të punësuarit F.S. i sistemuar në punët dhe detyrat punuese “Ujëinstalues-mjeshtër” në KRU “Hidromorava” Sh.A. me rekomandim të Komisionit Disiplinor, bazuar në nenin 85. të Ligjit të Punës nr.03/L-212, si dhe nenit 4. të Rregullores për përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të të punësuarve në KRU “Hidromorava”-Sh.A. | 1588 | 15.12.2025 |
| 8. | Vendim për shqiptimin e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” ndaj të punësuarit G.M. i sistemuar në punët dhe detyrat punuese “Vozitës i makinerisë së rëndë” në KRU “Hidromorava” Sh.A. me rekomandim të Komisionit Disiplinor, bazuar në nenin 85. të Ligjit të Punës nr.03/L-212, si dhe nenit 4. të Rregullores për përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të të punësuarve në KRU “Hidromorava”-Sh.A. | 1589 | 15.12.2025 |
| 9. | Vendim për formimin e komisioneve për regjistrimin e mjeteve themelore, inventarit, depove dhe arkave, në të gjitha njësitë punuese (Gjilan, Viti dhe Kamenicë), për vitin 2025. | 1596 | 18.12.2025 |
| 10. | Vendim për shqiptimin e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” ndaj të punësuarit M.S. i sistemuar në punët dhe detyrat punuese “Lexues i ujëmatësve dhe shpërndarës i faturave” në KRU “Hidromorava” Sh.A. me rekomandim të Komisionit Disiplinor, bazuar në nenin 85. të Ligjit të Punës nr.03/L-212, si dhe nenit 4. të Rregullores për përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të të punësuarve në KRU “Hidromorava”-Sh.A. | | |
| 11. | Vendim që punonjësit Kreshnik Aliu, Shef i Divizionit për Menaxhimin e Projekteve, t’i caktohet kompensim shtesë prej 0.30 njësi të koeficientit (72.00 €) për kryerjen e detyrave të menaxhimit dhe përcjelljes së punimeve të projektit ITUN (PIU), brenda dhe jashtë orarit të punës, përfshirë edhe punën gjatë vikendeve sipas nevojës. | 1654 | 29.12.2025 |
| 12. | Vendim për formimin e Komisionit për kategorizimin e konsumatorëve, me qëllim të mbështetjes së procesit të riprogramimit të borxheve ndaj KRU “Hidromorava” Sh.A. | 1656 | 30.12.2025 |
| 13. | Vendim për caktimin e Komisionit për pranimin e punëve të projektit “Kuçjet individuale në fshatin Uglar, Komuna Gjilan”. | 1561 | 08.12.2025 |
| 14. | Vendim për shqiptimin e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” ndaj të punësuarit B.H. i sistemuar në punët dhe detyrat punuese “Lexues i ujëmatësve dhe shpërndarës i faturave” në KRU “Hidromorava” Sh.A. me rekomandim të Komisionit Disiplinor, bazuar në nenin 85. të Ligjit të Punës nr.03/L-212, si dhe nenit 4. të Rregullores për përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të të punësuarve në KRU “Hidromorava”-Sh.A.. | 1587 | 15.12.2025 |

| | | | |
|-----|---|------|------------|
| 15. | Vendim për shqiptimin e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” ndaj të punësuarit F.S. i sistemuar në punët dhe detyrat punuese “Ujëinstalues-mjeshtër” në KRU “Hidromorava” Sh.A. me rekomandim të Komsionit Disiplinor, bazuar në nenin 85. të Ligjit të Punës nr.03/L-212, si dhe nenit 4. të Rregullores për përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të të punësuarve në KRU “Hidromorava”-Sh.A. | 1588 | 15.12.2025 |
| 16. | Vendim për shqiptimin e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” ndaj të punësuarit G.M. i sistemuar në punët dhe detyrat punuese “Vozitës i makinerisë së rëndë” në KRU “Hidromorava” Sh.A. me rekomandim të Komsionit Disiplinor, bazuar në nenin 85. të Ligjit të Punës nr.03/L-212, si dhe nenit 4. të Rregullores për përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të të punësuarve në KRU “Hidromorava”-Sh.A. | 1589 | 15.12.2025 |
| 17. | Vendim për formimin e komisioneve për regjistrimin e mjeteve themelore, inventarit, depove dhe arkave, në të gjitha njësitë punuese (Gjilan, Viti dhe Kamenicë), për vitin 2025. | 1596 | 18.12.2025 |
| 18. | Vendim për shqiptimin e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” ndaj të punësuarit M.S. i sistemuar në punët dhe detyrat punuese “Lexues i ujëmatësve dhe shpërndarës i faturave” në KRU “Hidromorava” Sh.A. me rekomandim të Komsionit Disiplinor, bazuar në nenin 85. të Ligjit të Punës nr.03/L-212, si dhe nenit 4. të Rregullores për përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të të punësuarve në KRU “Hidromorava”-Sh.A. | 1622 | 19.12.2025 |
| 19. | Vendim që punonjësit Kreshnik Aliu, Shef i Divizionit për Menaxhimin e Projekteve, t’i caktohet kompensim shtesë prej 0.30 njësi të koeficientit (72.00 €) për kryerjen e detyrave të menaxhimit dhe përcjelljes së punimeve të projektit ITUN (PIU), brenda dhe jashtë orarit të punës, përfshirë edhe punën gjatë vikendeve sipas nevojës. | 1654 | 29.12.2025 |
| 20. | Vendim për formimin e Komisionit për kategorizimin e konsumatorëve, me qëllim të mbështetjes së procesit të riprogramimit të borxheve ndaj KRU “Hidromorava” Sh.A. | 1656 | 30.12.2025 |

2. BORDI I DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve të KRU "Hidromorava" gjatë periudhës së tremujorit të katërt të vitit 2025, ka mbajtur tri /3/ mbledhje të rregullta.

2.1.Vendimet e Bordit të Drejtorëve

Të gjitha mbledhjet janë mbajtur me kuorum të plotë, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Punës së Bordit.

- **Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e dhjetë të mbajtur me datë: 31.10.2025 ka marrë këto vendime:**
 1. Unanimisht është miratuar "Raporti i Punës për muajin shtator të vitit 2025";
 2. Unanimisht është miratuar "Plani i Biznesit për periudhën 2026-2028";
 3. Unanimisht, është miratuar emërimi i z. Albion Ramadani në pozitën e Zyrtarit të Lartë Financiar dhe të Thesarit në KRU "Hidromorava" Sh.A.
 4. Unanimisht, shfuqizohet Vendimi nr. 482, të datës 04.04.2025, që ka të bëjë me emërimin e znj. Merita Xhelili si Ushtruese e Detyrës në pozitën e Zyrtares së Lartë Financiare të KRU "Hidromorava" Sh.A.;

- **Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e njëmbëdhjetë të mbajtur 26.11.2025 ka marrë këto vendime:**
 1. Unanimisht është miratuar "Raporti i Punës për muajin tetor të vitit 2025";
 2. Unanimisht është miratuar "Raporti i punës për tremujorin e tretë të vitit 2025".

- **Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e dymbëdhjetë të mbajtur me datë: 23.12.2025 ka marrë këto vendime:**
 1. Unanimisht është miratuar "Raporti i Punës për muajin nëntor të vitit 2025";
 2. Me shumicë votash, është miratuar propozimi i Kryeshefit Ekzekutiv për mbështetje financiare me nga 150.00€ për të gjithë të punësuarit në fund të vitit;
 3. Unanimisht, është miratuar "Plani për Siguri të Ujit";
 4. Unanimisht është miratuar "Plotësim/ndryshimi i Rregullores mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 648, i dt. 31.05.2024";
 5. Unanimisht është miratuar "Kodi i Etikës Profesionale dhe Standardit të Veshjes" në KRU "Hidromorava" Sh.A.

3. KOMISIONI I AUDITIMIT

Komisioni i Auditimit gjatë periudhës së tremujorit të katërt të vitit 2025, ka mbajtur dy /2/ mbledhje të rregullta dhe bazuar në procesverbalet e datës: 27.10.2025 dhe 19.11.2025 ka shqyrtuar këto çështje:

3.1. Vendimet e Komisionit të Auditimit

Komisioni i Auditimit i KRU “Hidromorava” Sh.A., në mbledhjen e gjashtë të mbajtur më 27.10.2025, ka shqyrtuar çështjet në vijim:

- Është shqyrtuar “Plani i Biznesit për periudhën 2026 – 2028”.

Komisioni i Auditimit i KRU “Hidromorava” Sh.A., në mbledhjen e shtatë të mbajtur më 19.11.2025, ka shqyrtuar çështjet dhe miratuar në vijim:

- Është shqyrtuar “Draft Raportit të tremujorit të tretë për vitin 2025”;
- Unanimisht është miratuar “Raporti i tremujorit të Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm”.

Komisioni i Auditimit, në tremujorin e katërt të vitit 2025, përmes postës elektronike ka shqyrtuar dhe marrë këto vendime:

- Me datë: 12.12.2025, unanimisht është miratuar “Raporti i Auditimit mbi ligjshmërinë e realizimit të projektit “Furnizimi me ujëmatës, bllokues dhe plomba për ujëmatës” – Auditimi 04/2025” dhe “Raporti i Auditimit për projektin “Kycjet individuale në fshatin Uglar – Komuna e Gjilanit”, KRU “Hidromorava” Sh.A., Nr. 05/2025”.
- Me datë: 31.12.2025, unanimisht është miratuar “Plani Strategjik i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për periudhën 2026–2028, KRU “Hidromorava” Sh.A., Nr. 06/2025 dhe “Plani Vjetor i Punës për Zyrën e Auditimit të Brendshëm për vitin 2026, KRU “Hidromorava” Sh.A., Gjilan, Nr. 07/2025”.

3.2. Përmbledhje e Raportit të Punës së Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm për periudhën e tremujorit të katërt të vitit 2025

Raporti i dorëzuar nga Zyrtari i Auditimit të Brendshëm (ZAB) për periudhën e tremujorit të katërt pasqyron rezultatet e arritura krahasuar me objektivat dhe detyrimet e planifikuara për këtë periudhë dhe përfaqëson një raportim tërësor e gjithëpërfshirës mbi punën e realizuar.

1. Auditimet e realizuara gjatë periudhës së tremujorit të katërt të vitit 2025

1. Raporti Final i Auditimit mbi ligjshmërinë e realizimit të projektit të furnizimit me ujëmatës, bllokues dhe plomba për ujëmatës, KRU “Hidromorava” Sh.A., Nr. 04/2025.
2. Raporti Final i Auditimit mbi ligjshmërinë e realizimit të projektit “Kycjet individuale në fshatin Uglar – Komuna e Gjilanit”, KRU “Hidromorava” Sh.A., Nr. 05/2025.

3. Plani Strategjik i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për periudhën 2026–2028, KRU “Hidromorava” Sh.A., Nr. 06/2025.
4. Plani Vjetor i Punës për Zyrën e Auditimit të Brendshëm për vitin 2026, KRU “Hidromorava” Sh.A., Gjilan, Nr. 07/2025.
5. Raporti Final i Auditimit – Auditimi i të hyrave: inkasimi nga shërbimet e ujit dhe kanalizimit, si dhe shërbimet e tjera, KRU “Hidromorava” Sh.A., Nr. 08/2025.

4. ZYRA E SEKRETARES/DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV

Gjatë periudhës së tremujorit të katërt të vitit 2025, Zyra e Sekretares së Ndërmarrjes ka realizuar me përkushtim detyrat funksionale dhe ligjore, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme për Bordin e Drejtorëve, Komisionin e Auditimit dhe menaxhmentin e lartë të Ndërmarrjes. Aktivitetet kryesore janë fokusuar në administrimin dhe arkivimin e dokumenteve zyrtare, përgatitjen e materialeve për mbledhjet e organeve udhëheqëse, hartimin e raporteve periodike të punës dhe përgatitjen e akteve administrative në përputhje me kornizën ligjore dhe rregulloret e brendshme të Ndërmarrjes.

Në kuadër të përgjegjësisve institucionale janë zhvilluar aktivitetet si në vijim:

Përgatitja e procesverbaleve të mbledhjeve:

Janë përgatitur procesverbalet për mbledhjet e rregullta të Bordit të Drejtorëve, Mbledhjes së Kuvendit Vjetor të Aksionarit dhe Komisionit të Auditimit, përkatësisht:

- Procesverbali i mbledhjes së nëntë të Bordit të Drejtorëve, mbajtur më 17.09.2025;
- Procesverbali i mbledhjes së dhjetë të Bordit të Drejtorëve, mbajtur më 31.10.2025;
- Procesverbali i mbledhjes së njëmbëdhjetë të Bordit të Drejtorëve, mbajtur më 26.11.2025;
- Procesverbali nga Mbledhja e Kuvendit Vjetor të aksionarit e datës: 13.10.2025;
- Procesverbali i mbledhjes së gjashtë të Komisionit të Auditimit, mbajtur më 27.10.2025;
- Procesverbali i mbledhjes së shtatë të Komisionit të Auditimit, mbajtur më 19.11.2025;

Përgatitja e raporteve periodike të punës:

Janë hartuar dhe finalizuar dokumentet raportuese si në vijim:

- Raporti i Punës për muajin shtator, tetor dhe nëntor 2025;
- Raporti i Punës për tremujorin e tretë (korrik, gusht dhe shtator 2025).

Përgatitja e vendimeve dhe dokumentacionit administrativ:

Janë përgatitur të gjitha vendimet që janë miratuar nga menaxhmenti i Ndërmarrjes, duke u siguruar që të gjitha aktet administrative të jenë në përputhje me rregullat e brendshme dhe kornizën ligjore në fuqi.

4.1. Zyra e Burimeve Njerëzore

Gjatë periudhës së tremujorit të katërt të vitit 2025, Zyra e Burimeve Njerëzore ka menaxhuar dhe aprovuar pushimet e punëtorëve, përpiluar kontrata në vepër si dhe ka shqyrtuar kërkesat e punëtorëve, si më poshtë:

- Janë aprovuar gjithsej njëqind e shtatë (107) pushime vjetore dhe tridhjet e tetë (38) pushime mjekësore, përfshirë pushimet mujore të punëtorëve për tetor, nëntor dhe dhjetor.
- Janë nxjerrur pesë (5) vendime për sistemim të përkohshëm dhe një vendim për sistemim të përhershëm të punëtorëve me qëllim përmirësimin e mëtutjeshëm të rezultateve të punës.
- Janë pranuar pesë (5) kërkesa nga pesë punëtorë të kompanisë.
- Janë rikthyer përgjigjet për pesë (5) kërkesa të punëtorëve të Ndërmarrjes.
- Është aprovuar pushimi pa pagesë për punëtorin znj.R.A. për periudhën një mujore (nga 06.10.2025 deri më 05.11.2025).
- Është nxjerrë vendimi për plotësim/ndryshimin e përbërjes së komisionit disiplinor, me rastin e ndërrimit të pozitës së z.A.R.

Në cilësinë e anëtarit të komisionit disiplinor janë nxjerrë rekomandimet për masa disiplinore ndaj pesë (5) punëtorëve të Ndërmarrjes për shkak të shkeljeve të detyrave të punës.

Në cilësinë e anëtarit të komisionit për shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve janë shqyrtuar njëzet e tre (23) ankesa dhe i janë kthyer përgjigjet palëve ankuese.

4.1.1. Struktura e të punësuarve

KRU "Hidromorava" Sh.A Gjilan, gjatë kësaj periudhe ka operuar me gjithsej 170 të punësuar.

Tabela 3. Numri i të punësuarve në njësitë punuese gjatë periudhës së TM4/2025

| Numri i të punësuarve në njësitë e caktuara punuese | Gjilan | Kamenicë | Viti |
|---|--------|----------|------|
| | 135 | 16 | 19 |

Tabela 4. Struktura gjinore e të punësuarve gjatë periudhës së TM4/2025

| Numri i të punësuarve sipas përkatësisë gjinore | Numri i të punësuarve (meshkuj) | Numri i të punësuarve (femra) |
|---|---------------------------------|-------------------------------|
| | 145 | 25 |

4.1.2. Procedurat e rekrutimit dhe përmbyllja e konkurseve

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2025 nuk janë iniciuar apo zhvilluar procedura të reja të rekrutimit.

4.2. Zyra ligjore

Gjatë periudhës së tremujorit të katërt të vitit 2025, KRU "Hidromorava" Sh.A. në Gjilan, nga ana e gjykatave kompetente ka pranuar lëndët e paraqitura në tabelën e mëposhtme.

Tabela 5. Lëndët e pranuar nga Gjykatat kompetente gjatë periudhës së TM4/2025

| Lëndët e pranuar nga gjykatat kompetente | | | |
|--|--|------------------------------------|--|
| Datë | Institucioni | Nr. Aktvendimit/ Aktgjykimit | Arsyetimi |
| 15.10.2025 | Gjykata e Apelit – Prishtinë | CAP.nr.168/25 e dt. 14.08.2025 | Me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, CAP.nr.168/2025, të datës 14.08.2025, është refuzuar si e pabazuar ankesa e kreditorit KRU "Hidromorava" Sh.A. ndaj debitores Vaide Shabani nga Gjilani. Me këtë aktvendim është vërtetuar Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, CKP.nr.109/24, i datës 16.12.2024, me të cilin është shfuqizuar urdhri përmbarimor në pjesën që i referohet borxhit në shumën prej 1,284.85 €, ndërsa është lënë në fuqi urdhri përmbarimor për shumën prej 59.34 €. |
| 22.10.2025 | Gjykata e Apelit e Kosovës – Prishtinë | CAP.nr. 1735/2024 i dt. 07.10.2025 | Me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, CAP.nr.1735/2024, të datës 07.10.2025, është refuzuar si e pabazuar ankesa e debitorit Fadil Ajvazi nga Gjilani. Me këtë vendim, është vërtetuar Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, CPK.nr.15/2024, të datës 02.08.2024, sa i përket borxhit në shumën prej 1,577.05 €. |
Bazuar në rezultatet e analizave fiziko – kimike dhe mikrobiologjike të punura në laboratorin qendror të KRU "Hidromorava", në Qendrën Rajonale të Shëndetit Publik në Gjiilan – QRSHP si dhe Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike - IKSHIPK, cilësia e ujit gjatë periudhës së tremujorit të katërt të vitit 2025, ka qenë rreth 99% në përputhje me vlerat parametrike për ujin e pijshëm.

- Duke u bazuar në Planin për Monitorim të Cilësisë së Ujit, në KRU "Hidromorava", monitorimi i cilësisë së ujit bëhet nëpërmjet dhjetë zonave të ndara sipas karakteristikave të ujit.
 1. **Zona HM 01** – burimi "Guri i Hoxhës" dhe "Liçeni i Përlepticës", kjo është zona më e madhe në KRU "Hidromorava";
 2. **Zona HM 02** – burimet e ujit në "Pasjan", "Fabrika e Përpunimit të Ujit në Velekincë";
 3. **Zona HM 03** – burimi "Baja";
 4. **Zona HM 04** – zonat rurale (burimet e ujit në Malishevë, Zhegër, Doberqan, Llovcë dhe Bilinicë);
 5. **Zona HM 05** – Letnica, Fabrika për Përpunimin e Ujit në Letnicë;
 6. **Zona HM 06** – burimet e ujit në fshatin Pozharan;
 7. **Zona HM 07** – burimet e ujit në Kamenicë, fshatin Karaçevë dhe Shipashnicë;
 8. **Zona HM 08** – burimet e ujit në fshatin Topanicë dhe Koretin;
 9. **Zona HM 09** – burimet e ujit në fshatin Makresh, Novoberdë;
 10. **Zona HM 10** – burimet e ujit në Ranillug dhe fshatin Ropotovë.

Parametrat të cilat kontrollohen për ta vërtetuar cilësinë e ujit janë:

- **Parametrat fizik të cilët janë punuar janë:** era, ngjyra, shija, përqeshmëria elektrike, turbullira fortësia e ujit.
- **Parametrat kimik të cilët janë punuar:** pH, klorigjyri, amoniaku, nitritet, nitratet, sulfatet, hekuri, mangani, kalciumi, magnezi, shpenzimi i KMnO₄, fosfatet, kloruret, alumini.
- **Parametrat mikrobiologjik të cilët janë punuar:** numri i tërësishëm i bakteve koliforme në 100 ml, bakteret koliforme me prejardhje fekale në 100 ml, numri i tërësishëm i bakteve të gjalla në 1 ml në 37 gradë celsius, streptokoket me prejardhje fekale në 100ml.

Në baza tre mujore punohen edhe metalet e rënda, trehalometanet THM, si dhe karboni total organik TOC.

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2025 (tetor – nëntor – dhjetor), është realizuar monitorimi i rregullt i cilësisë së ujit të pijes në të gjitha zonat e shërbimit të Kompanisë, në përputhje me planin vjetor të monitorimit dhe standardet ligjore në fuqi.

Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar disa mospërputhje të përkohshme të vlerave parametrike, të cilat janë menaxhuar në kohë përmes masave teknike dhe operative përkatëse, si dhe përmes njoftimit të rregullt të konsumatorëve, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit publik. Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2025 kemi pasur mospërputhje të vlerave parametrike në këto zona:

Muaji tetor 2025

Gjatë këtij muaji janë evidentuar disa mospërputhje të vlerave parametrike në stacionet e mëposhtme:

- **HM02 – Rezervuari i ITU-së në Velekincë**

Në këtë zonë, në një mostër është konstatuar tejkalim i vlerave parametrike mikrobiologjike. Megjithatë, në të njëjtën ditë, në rrjetin shpërndarës në pikën e mostrimit Spitali, i cili furnizohet nga ky rezervuar, të gjithë parametrat kanë rezultuar brenda standardeve të lejuara, si nga aspekti kimik ashtu edhe ai mikrobiologjik.

- **HM04 – Stacioni i Pompimit Zhegër**

Në këtë zonë është identifikuar një mostër me mospërputhje të vlerave parametrike mikrobiologjike, andaj masë korrigjuese dhe parandaluese, është rritur niveli i dezinfektimit me klor në ujë.

- **HM05 – ITU Viti**

Si pasojë e reshjeve atmosferike dhe pamundësisë së trajtimit të ujit deri në arritjen e vlerave brenda normave të lejuara, konsumatorët në këtë zonë janë njoftuar që uji të mos përdoret për pije deri në stabilizimin e parametrave.

- **HM09 – Stacioni i Pompimit Makresh**

Në këtë zonë është vërejtur rritje e turbullirës së ujit si rezultat i reshjeve atmosferike dhe lidhur me këtë, konsumatorët janë njoftuar për mos-përdorimin e ujit për pije.

Muaji nëntor 2025

Gjatë këtij muaji janë evidentuar disa mospërputhje të vlerave parametrike në stacionet e mëposhtme:

- **HM01**

Në këtë zonë, janë konstatuar mospërputhje të izoluara të parametrave fizikë dhe kimikë. Konkretisht, në një mostër është evidentuar tejkalim i vlerës standarde për **mangan**, si dhe rritje e përkohshme e **turbullirës**. Pas ndërhyrjeve teknike të nevojshme, vlerat janë stabilizuar brenda normave të lejuara gjatë së njëjtës ditë.

- **HM08 – Stacioni i Pompimit Koretin**

Në këtë zonë, si pasojë e reshjeve intensive atmosferike, ka pasur depërtim të ujërave sipërfaqësore në sistemin e furnizimit, duke shkaktuar rritje të parametrave mikrobiologjikë. Për menaxhimin e situatës, është rritur niveli i dezinfektimit me klor, në përputhje me procedurat teknike në fuqi.

- **HM10 – Stacioni i Pompimit Ranillug**

Në këtë zonë, për shkak të depërtimit të ujërave sipërfaqësore të ndotura në sistemin e furnizimit, është marrë masa e ndërprerjes së përkohshme të furnizimit me ujë. Konsumatorët janë njoftuar me kohë për situatën dhe masat e ndërmarra.

Muaji dhjetor 2025

Gjatë këtij muaji janë evidentuar disa mospërputhje të vlerave parametrike në stacionet e mëposhtme:

- **HM01**

Në këtë zonë është konstatuar mospërputhje e vlerave të parametrave kimikë, konkretisht tejkalim i vlerës standarde për nitratet në një mostër. Konsumatorët janë njoftuar në kohë përmes mjeteve të informimit publik.

- **HM10 – Stacioni i Pompimit Ranillug**

Në këtë zonë, si pasojë e depërtimit të ujërave sipërfaqësore të ndotura, është ndërprerë përkohësisht furnizimi me ujë nga burimi kryesor. Paralelisht, konsumatorët janë furnizuar nga një burim alternativ i përkohshëm, deri në stabilizimin e vlerave parametrike në burimin kryesor. Konsumatorët janë njoftuar vazhdimisht për situatën dhe masat e ndërmarra.

Përfundime

Të gjitha situatat e evidentuara gjatë periudhës tetor, nëntor dhe dhjetor janë menaxhuar në përputhje me procedurat operative dhe standardet ligjore në fuqi. Masat e ndërmarra kanë përfshirë ndërhyrje teknike, rritje të dezinfektimit, ndërprerje të përkohshme të furnizimit kur ka qenë e nevojshme, si dhe njoftim të rregullt të konsumatorëve.

Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së ujit do të vazhdojë edhe në periudhën në vijim, me qëllim garantimin e furnizimit të sigurt dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

8. DEPARTAMENTI TEKNIK

8.1 Aktivitetet kryesore të drejtorit teknik

Gjatë periudhës së tremujorit të katërt të vitit 2025, janë realizuar këto aktivitete:

- **Ankesat e konsumatorëve pa rrjetë ujësjellësi:** Në bashkëpunim me menaxherin e rrjetit të ujësjellësit janë shqyrtuar kërkesat e konsumatorëve për kyçe në rrjetin ekzistues të ujësjellësit dhe janë identifikuar mundësitë teknike për realizim.
- **Takim me menaxherët e divizioneve teknike për hartimin e Planit të Menaxhimit të UM:** Në vijim të rekomandimeve nga raporti i besueshmërisë i ARRU-së, janë mbajtur takime të rregullta për mbarëvajtjen e procesit të punës
- **Përgatitja e projekteve për Planin e Biznesit 2026 dhe Planin Trevjeçar 2026–2028:** Divizioni i Planifikimit, në bashkëpunim me divizionet tjera, përgatitja e projekteve prioritare që do tenderohen në janar 2026
- **Përgatitja e raportit mujor për muajt tetor dhe nëntor:** Janë mbledhur dhe përmbledhur raportet e menaxherëve të divizioneve teknike dhe njësisve operative në një raport unik, i cili është dorëzuar te Sekretarja e Ndërmarrjes.
- **Takime javore me njësitë operative Viti dhe Kamenicë, si dhe me menaxherët e divizioneve teknike:** Janë diskutuar çështjet operative, defektet e ndodhura gjatë javës dhe detyrat e planifikuara për periudhën pasuese.
- **Vizita në Njësinë Operative të Kamenicës:** Bashkë me koordinatoren për humbje të ujit, është vizituar njëسيا e Kamenicës, gjegjësisht janë vizituar fshatrat e marrura në menaxhim në nëntor (Muçivërca, Dajkoveci, Shipashnica e Poshtme, Hodonovci, Novosella dhe Rogana), për përcaktimin e lokacioneve ku do të vendosen UM e prodhimit, për secilin fshat
- **Takime ditore (brief) me menaxherët e divizioneve:** Janë zhvilluar takime të përditshme për koordinimin e aktiviteteve operative dhe menaxhimin e defekteve në terren.
- **Projekti i Cernicës – takim koordinues:** Është mbajtur takim me operatorin ekonomik, për vazhdimin e punimeve.
- **Aktivitete për procesin tarifor:** Në bashkëpunim me menaxherin e Divizionit të Planifikimit dhe menaxherët tjerë, janë bërë ndryshimet në projekte, sipas rekomandimeve të ARRU-së
- **Takim me kryetarin e Novobërdës-**Është mbajtur takim me kryetarin e Novobërdës, ku kërkesë e tyre ka qenë lidhja e fshatit Stanishor në rrjetin e ujësjellësit.
- **Kërkesat e dy bizneseve për kyçe në gypin transportues DN 400, nga Përlepnicë në qytet-**Bashkë me menaxherin e rrjetit të ujësjellësit dhe menaxherin e Planifikimit janë vizituar këto dy biznese, për me definuar se ku dhe sim und të realizohet kyqja e tyre në rrjetë
- **Vizita e ITU Përlepnicë-**Me menaxherin për cilsi të ujit është vizituar ITU Përlepnicë, gjegjësisht identifikimi i defektit të UM të prodhimit të ujit të patrajtuar nga penda
- **Takim me kompaninë Zvicerane FELA-** Është mbajtur takim me përfaqësuesin e kompanisë zvicerane FELA, që ka bërë ndërtimin e ITU-Velekincë. Qëllimi i takimit ka qenë diskutimi i problemeve që kemi me automatikën e sistemit SCADA

- **Vizita në teren e rrugëve, ku do të ndërrohen gypat**-Me inxhinieren e departamentit të planifikimit dhe me menaxherin e departamentit të rrjetit të ujësjellësit janë vizituar rrugët: “Beqir Musliu”, “Hamdi Berisha”, “Nëna Terezë” etj, për të cilat do të bëhet ndërrimi i gypave
- **Paramasa dhe Paralogaria**- Është punuar në paramasën dhe paralogarinë e ndërrimit të gypave që do të tenderohen në janar, projekte të cilat janë me proces tarifor sipas PMA.

Tabela 37. Takimet e Drejtorit Teknik me institucionet relevante dhe operator ekonomik, gjatë TM4/2025

| Nr. | Institucioni | Data | Qëllimi i takimit |
|-----|--|------------|---|
| 1. | DSHP | 24.10.2025 | <p>Është mbajtur një takim koordinues me Drejtorin e Shërbimeve Publike të Komunës së Gjilanit dhe menaxherin e projektit të ujësjellësit në lagjen Fidanishtja II. Gjatë takimit u konstatua se projekti në fjalë po realizohej nga Komuna e Gjilanit pa njoftim paraprak ndaj KRU “Hidromorava”, si operator përgjegjës për sistemin e furnizimit me ujë.</p> <p>Drejtori i Shërbimeve Publike kërkoi që në të ardhmen të ketë koordinim të detyrueshëm me KRU “Hidromorava” për çdo projekt që ka të bëjë me ujësjellësin dhe kanalizimin fekal, me qëllim të shmangies së mospërputhjeve teknike dhe operacionale.</p> <p>Qëllimi kryesor i takimit ishte koordinimi i realizimit të kyçjeve individuale nga ana e KRU “Hidromorava”, të cilat vlerësohen të jenë rreth 75 kyçje. Në këtë drejtim, KRU “Hidromorava” do të shqyrtojë mundësinë e realizimit të këtyre kyçjeve, në përputhje me kapacitetet teknike dhe operative.</p> <p>Po ashtu, është kërkuar që KRU “Hidromorava” të caktojë një inxhinier përgjegjës për përcjelljen dhe mbikëqyrjen e punimeve në terren, deri në përfundimin e plotë të projektit.</p> |
| 2. | Takim me Operatorin Ekonomik, për projektin e Cërnicës | 27.10.2025 | <p>Është mbajtur një takim me operatorin ekonomik, mbikëqyrësin dhe menaxherin e projektit, gjatë të cilit është diskutuar vazhdimi i punimeve, si si dhe ndryshimet e nevojshme që duhet të bëhen në projekt. Gjatë takimit, operatorit ekonomik i është kërkuar që deri më 15 dhjetor të dorëzojë një njoftim të detajuar lidhur me punët që do të realizohen dhe vlerën</p> |

| | | | |
|----|--|------------|---|
| | | | financiare të tyre, me qëllim që të iniciohet kërkesa pranë ME për ridestinimin e mjeteve financiare të papërdorura për projektin Fidanishtja II, duke pasur parasysh se lënda është proceduar në OSHP. |
| 3. | Cross Border Cooperation (CBC)-Bashkëpunimi Ndërkufitar | 07.11.2025 | <p>Është mbajtur një takim njoftues me Drejtoreshën e Programit, znj. Mediana Bislimi, si dhe me konsulentin e programit, znj. Njomza, e cila prezantoi në mënyrë të detajuar programin dhe objektivat e tij.</p> <p>Nga KRU "Hidromorava" Sh.A. në takim morën pjesë Valon Maliqi, Granit Sylejmani, Amir Rexha dhe Elhame Shefkiu.</p> <p>Qëllimi i takimit ishte njohja me programin dhe vlerësimi i mundësive për ndërlidhjen e projekteve të KRU "Hidromorava" me këtë program, me synim aplikimin në të ardhmen. Si projekt me potencial për aplikim u vlerësua projekti i përfshirë në Planin e Biznesit të ndërmarrjes, me titull "Sigurimi i burimeve të ujit dhe vendosja e sondave për kontrollin e parametrave të ujit", me vlerë të parashikuar prej 400,000.00 €.</p> |
| 4. | Takim me Operatorin Ekonomik për projektin: Ndërrimi i gypit të rrjetit të ujërave të kanalizimit në rrugën Abdullah Tahiri me gjatësi L=450 m- ri tender. | 26.11.2025 | Është mbajtur një takim me operatorin ekonomik, mbikëqyrësin dhe menaxherin e projektit, gjatë të cilit është diskutuar fillimi i punimeve. |

8.2 Divizioni për Prodhimin e Ujit dhe Stacionet e Pompimit

8.2.1 Furnizimi me ujë dhe defektet e paraqitura

Gjatë periudhës së tremujorit të katërt të vitit 2025 është vërejtur një rënie e ndjeshme e nivelit të ujit në akumulacionin e Përlepnicës, në nëntor 2025 ka arritur nivelin prej **21.14 m**. Edhe burimi “Baja” ka shënuar rënie të debitit, që gjatë ditës ka pas ndërprerje të përkohshme të furnizimit për të mundësuar mbushjen e rezervuarëve.

Burimet tjera ujore në rajon, si “Guri i Hoxhës” dhe pusët në Velekincë, kanë qenë në gjendje më të qëndrueshme, megjithëse është vërejtur një rënie e lehtë e kapacitetit. Në disa sisteme rurale janë raportuar ndërprerje të herëpashershme të furnizimit, si pasojë e uljes së niveleve të ujit.

Funksionimi i stacioneve të pompimit është zhvilluar përgjithësisht pa probleme të mëdha; defektet e paraqitura në rrjetin e ujësjellësit janë adresuar në kohë falë reagimit efikas të ekipeve teknike. Përpjekjet gjatë kësaj periudhe janë përqendruar në ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet prodhimit dhe konsumit, me qëllim shmangien e mbiprodhimit dhe mbrojtjen e infrastrukturës.

Gjatë kësaj periudhe, sasia totale e ujit të prodhuar ka qenë 2,240,299 m³, ndërsa sasia e faturuar ka arritur në 1,008,559 m³, që përkon me një UPF prej 55%.

Pas reshjeve të shiut, furnizimi me ujë ka filluar të normalizohet si dhe situata me stacionet e pompimit, gjegjësisht prodhimi i ujit në sistemet rurale ka qenë i qëndrueshëm, përveç në sistemet rurale të Kamenicës që kanë pasur disa probleme me funksionimin e elektropompave.

Niveli i akumulacionit në muajin dhjetor ka arritur nivelin maksimal 30.3m.

Periudha e tremujorit të katërt të vitit 2025, është karakterizuar me disa probleme teknike, kryesisht me defekte në pompa, defekte në procesin komandimit në mes të rezervuarëve dhe stacioneve të pompimit.

Siç është raportuar edhe në raportet mujore, këto defekte janë evituar shumë shpejt, përveç atyre problemeve tek të cilat kërkohen procedura të prokurimit për sigurimin e pajisjeve të dëmtuara dhe që prolongohet zgjidhja e problemeve, shkaku i këtyre procedurave.

Përfundimisht mund të themi se periudha e tremujorit të katërt të vitit 2025, është karakterizuar me probleme të vogla, kur bëhet fjalë për funksionimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm, të prodhuar/përpunuar nga impiantet dhe stacionet e pompimit.

Aktivitetet tjera kanë të bëjnë me angazhimet në projektin “Flows”, si dhe komisione të ngjashme të projekteve të financuara nga buxheti i kompanisë sonë.

Defektet e evituara gjatë kësaj periudhe janë:

- 09.07.2025 – Lagjia Malësia: Është ndërprerë funksionimi i elektropompës për shkak të dëmtimit të motorit me fuqi 2.2 kW. Pajisja është zëvendësuar dhe furnizimi me ujë është rikthyer në gjendje normale.
- 03.10.2025 – ITU Përlepnicë: Është realizuar ristartimi i pompave të impiantit.

- 06.10.2025 – ITU Përlepnice: Është instaluar lidhësja e baterisë së inverterit, si dhe është zëvendësuar siguresa trepolare e ndriçimit të jashtëm.
- 07.10.2025 – ITU Përlepnice: Është bërë izolimi i kabllorëve të ndriçimit gjatë punimeve në impiant.
- ITU Velekincë: Gjatë disa ditëve janë kryer ndërhyrje në izolimin e kabllorëve të dëmtuara nga brejtësit në panelin ku janë të vendosura PLC-të. Janë bërë përpjekje për rregullimin e komunikimit ndërmjet ITU Velekincë dhe rezervuarit Kodra e Dëshmorëve, por pa sukses.
- 21.10.2025 – ITU Përlepnice: Ekipi teknik ka realizuar instalimin e kamerave për monitorimin e gjeneratorit.
- 22.10.2025 – Makresh: Në stacionin e pompave është intervenuar në rregullimin e notuesit elektrik. Po atë ditë, në ITU Përlepnice është demontuar dhe pastruar aktuatori i pulzatorit; për shkak të angazhimeve të tjera, testimi i funksionalitetit ende nuk është realizuar.
- 29.10.2025 – Baja–Pasjak: Është intervenuar në rregullimin e pajisjes komunikuese ndërmjet stacionit të pompave Baja dhe rezervuarit në Pasjak. Pajisja ishte dëmtuar nga rrufeja dhe është dërguar për servis, por për shkak të mungesës së pjesëve, riparimi ende nuk është përfunduar.
- Stacioni i pompave Bilinicë: Janë siguruar pajisjet e nevojshme për vënien në funksion të pusit të shkollës. Nevojitet koordinim me menaxherin e rrjetit për nxjerrjen dhe verifikimin e pompës ekzistuese; në rast jofunksionaliteti, parashihet zëvendësimi me pompë të re.
- 12.11.2025 – Fshati Llovë: Pas zëvendësimit dhe akordimit të relës tarifore, është rikthyer funksionimi normal i sistemit të pompimit. Më 28.12.2025, pas rregullimit shtesë të relës dhe kthesës së gypit 2'', sistemi është stabilizuar plotësisht.
- ITU Përlepnice: Është rikthyer në funksion Filtri Nr. 2, pas sigurimit të kartelës analoge të sistemit SCADA.
- ITU Përlepnice: Është konstatuar dëmtimi i ujëmatësit DN 400, i cili mat sasinë e ujit të papërpunuar. Për këtë qëllim është në përgatitje paramasa, pas së cilës do të procedohet me tenderim.
- Fshati Bilinicë: Ka përfunduar kycja e pusit të shkollës në sistemin e pompimit të fshatit. Aktualisht kjo pompë është inaktive, pasi nevojat për furnizim mbulohen nga pusi ekzistues.
- Velekincë – Fusha e puseve, Pusi Nr. 3: Është realizuar zëvendësimi dhe aktivizimi i pompës. Me vënien në funksion, kapaciteti i prodhimit është rritur ndjeshëm dhe arrin deri në 200 m³.
- ITU Velekincë: Është instaluar pompa e re për pastrimin e filtrave nga kontraktori EJONA; megjithatë, për shkak të instalimit jo adekuat, pompa nuk është futur ende në funksion as gjatë muajit dhjetor.
- ITU Velekincë – Kodra e Dëshmorëve: Kontraktori i projektit FLOWS ka filluar instalimin e pompave shtytëse; aktiviteti është ende në proces.
- 12.12.2025 – Fshati Muçivërcë: Në stacionin e pompave është instaluar elektropompë centrifugale vertikale me fuqi 15 kW.

8.2.2. Implementimi i projektit FLOWS

Punimet në kuadër të projektit FLOWS janë duke u zhvilluar sipas planit dhe deri më tani nuk janë evidentuar probleme të theksuara që do të mund të ndikojnë në ndërprerjen e tyre.

8.2.3. Sasia e ujit të prodhuar, ujit të faturuar dhe humbjeve të ujit

Sasia e ujit të prodhuar dhe të faturuar, si dhe uji i pafaturuar – UPF, gjatë tremujorit të katërt të vitit 2025, për secilë komunë veçmas, është paraqitur në tabelën më poshtë:

Tabela 38. Sasia e ujit të prodhuar, faturuar dhe ujit të pafaturuar gjatë periudhës së TM4/2025 për secilën komunë

| | Prodhimi TM4-2025 (m ³) | Faturimi TM4-2025 (m ³) | UPF TM4-2025 (%) | Prodhimi TM4-2024 (m ³) | Faturimi TM4-2024 (m ³) | UPF TM4-2024 (%) |
|-----------|---|---|------------------------|---|---|------------------------|
| Gjilan | 1,528,972 | 727,730 | 52.4 | 1,513,798 | 797,161 | 47.34 |
| Partesh | 9,222 | 2,640 | 71.37 | 12,104 | 1,104 | 90.88 |
| Viti | 410,010 | 136,963 | 66.60 | 397,950 | 121,306 | 69.52 |
| Kamenicë | 265,131 | 131,657 | 50.34 | 204,965 | 121,071 | 40.93 |
| Ranillugë | 16,315 | 7,733 | 52.6 | 19,586 | 10,348 | 47.17 |
| Novobërdë | 10,649 | 1,836 | 82.76 | 10,526 | 2,885 | 72.59 |

Tabela 39. Sasia e ujit të prodhuar, faturuar dhe ujit të pafaturuar gjatë periudhës së TM4/2025

| Burimi | Prodhimi TM4- 2025 | Faturimi TM4- 2025 | UPF [%] TM4 | Prodhimi TM4-2024 | Faturimi TM4-2024 | UPF (%) TM4-2024 | Trendi |
|-------------------------------------|--------------------------|--------------------------|-------------------|----------------------|----------------------|---------------------|---------|
| ITU Përlepnicë dhe Guri i Hoxhës | 989,631 | 69,7202 | 50.9 | 991,855 | 764,333 | 46.6 | Negativ |
| FPU Velekincë | 308,071 | | | 300,196 | | | |
| Baja*10 | 122,026 | | | 138,623 | | | |
| Pasjan (komulative) | 9,222 | 2,640 | 71.4 | 12,104 | 1,104 | 90.9 | Pozitiv |
| Malisheva e Ulët | 1,9901 | 4,684 | 76.5 | 18,062 | 4,363 | 75.8 | Negativ |
| Llovcë | 687 | 734 | -6.8 | 679 | 1,309 | -92.8 | / |
| Dobërçan*10 | 24,113 | 2,786 | 88.4 | 11,734 | 2,509 | 78.6 | Negativ |
| Zhegër*10 | 63,870 | 21,701 | 66.0 | 51,290 | 23,783 | 53.6 | Negativ |
| Billinicë | 673 | 623 | 7.4 | 1,359 | 864 | 36.4 | Pozitiv |
| ITU Letnicë - Viti | 27,5240 | 91,820 | 66.6 | 287,020 | 85,640 | 70.2 | Pozitiv |

| | | | | | | | |
|-------------------------------------|-----------|-----------|------|-----------|-----------|--------|---------|
| Tërstenik | 55,030 | 8,798 | 84.0 | 48,220 | 9,161 | 81 | Negativ |
| Pozhoran | 75,350 | 34,954 | 53.6 | 58,840 | 25,126 | 57.3 | Pozitiv |
| Ujesjellesi Letnicë | 4,390 | 1,391 | 68.3 | 3,870 | 1,379 | 64.4 | Negativ |
| Stacioni i pompimit nr. 1, Kamenicë | 12,400 | 83.096 | 38.6 | 45,980 | 80,077 | 43.2 | Pozitiv |
| Stacioni i pompimit nr. 2, Kamenicë | 6,8949 | | | 30,809 | | | |
| Stacioni i pompimit nr. 3, Kamenicë | 5,434 | | | 6,577 | | | |
| Stacioni i pompimit nr. 4, Kamenicë | 20,510 | | | 53,112 | | | |
| Stacioni i pompimit nr. 5 Kamenicë | 4,080 | | | 4,520 | | | |
| Stacioni i pompimit nr. 6 Kamenicë | 2,3956 | | | | | | |
| Topanicë | 18,400 | 9,495 | 48.4 | 17,719 | 10,882 | 38.6 | Negativ |
| Kopërnice&Kolloleq | 6,850 | 4,925 | 28.1 | 2,260 | 5,724 | -153.3 | Negativ |
| Koretin | 14,790 | 8,772 | 40.7 | 17,000 | 10,722 | 36.9 | Negativ |
| Shipashnicë | 29,589 | 5,980 | 79.8 | 17,000 | 8,727 | 48.7 | Negativ |
| Karaqevë | 6,103 | 3,453 | 43.4 | 9,988 | 4,939 | 50.6 | Pozitiv |
| Ranillug | 10,963 | 5,432 | 50.5 | 12,010 | 7,613 | 36.6 | Negativ |
| Ropotovë | 5,352 | 2,301 | 57.0 | 7,576 | 2,735 | 63.9 | Pozitiv |
| Boston, Qulkoc, Makresh | 10,649 | 1,836 | 82.8 | 10,526 | 2,885 | 72.9 | Negativ |
| Gjashtë fshatrat në Kamenicë | 54,070 | 15,936 | 70.5 | | | | --/ // |
| Prodhimi TOTAL m ³ /TM4 | 2,240,299 | 1,008,559 | 55.0 | 2,158,929 | 1,052.620 | 51.24 | Negativ |

Konkluzion – UPF dhe faturimi – TM4 2025

Rritja e prodhimit të ujit gjatë periudhës së tremujorit të katërt të vitit 2025, vjen si rezultat i disa faktorëve kryesorë, përkatësisht:

- Duke filluar nga muaji nëntor, është marrë në menaxhim sistemi i ujësjellësit për gjashtë fshatra të Komunës së Kamenicës (Hodonovc, Shipashnicë e Poshtme, Roganë, Muçivercë, Dajkovc dhe Novosellë), çka ka reflektuar në një rritje të prodhimit prej 54,070 m³.
- Është vënë në funksion sistemi i pompimit nr. 6 në Kamenicë (Berivojë), me një prodhim shtesë prej 17,400 m³.
- Në rritjen e prodhimit ka ndikuar gjithashtu sistemi i Doberçanit, ku vetëm gjatë muajit dhjetor 2025 është evidentuar një rritje prej 11,408 m³ krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Për këtë arsye janë iniciuar menjëherë verifikimet përkatëse, duke filluar nga kontrolli i komunikimit të rezervuarit dhe inspektimet në rrjet, me qëllim identifikimin e mundshëm të defekteve.
- Po ashtu, në sistemin e Malishevës është shënuar një rritje e prodhimit prej 5,497 m³ krahasuar me muajin dhjetor të vitit 2024, për të cilën kërkohet verifikim i mëtejshëm për identifikimin e burimit të humbjeve apo defekteve eventuale.

Në kushte normale, rritja e prodhimit të ujit do të duhej të reflektohej në rritje proporcionale të faturimit. Megjithatë, në këtë rast, pavarësisht rritjes së prodhimit, është evidentuar një rënie e faturimit të ujit, çka tregon për rritje të nivelit të humbjeve teknike dhe/ose komerciale, dhe paraqet nevojën për ndërhyrje të menjëhershme në aspektin e kontrollit të rrjetit, menaxhimit të matjes dhe verifikimit të konsumit.

8.3 Mirëmbajtja e Rrjetit të Ujësjellësit

Në përgjithësi në zonat e shërbimit gjatë periudhës së tremujorit të katërt të vitit 2025, kemi pasur (349) intervenime të natyrave të ndryshme si rrjedhje/plasaritje të gypave në rrjet, dëmtim i valvulave etj. Në Njësinë Operative në Gjilan kanë qenë (235) intervenime, në Njësinë Operative në Kamenicë (64) intervenime, në Njësinë Operative në Viti (48) intervenime, në Komunën e Ranillugut (6) intervenime dhe në Komunën e Novobërdës (3) intervenime, ndërsa në Komunën e Parteshit nuk ka pasur intervenime në rrjetin e ujësjellësit.

Tabela 40. Zona e shërbimit, numri dhe natyra e defekteve të ndodhura gjatë periudhës së TM4/2025

| Zona e shërbimit | Numri i defekteve | Lagjet/rrugët/vendbanimet | Natyra e defekteve |
|------------------|-------------------|---|--|
| Gjilan | 202 | <p>Tetor: Fshatrat: Pasjan, Zhegër, Shillovë, Kosaqë, Malishevë, Llovcë, Përlepnice, Livoç i Ulët, Velekincë.</p> <p>Rrugët: "Fatmir Ibishi", "Zija Shemsiu", "Xheladin Kurbaliu", "Selman Riza", "Afrim Zhitija", "Gjon Sereqi", "Hysen Tërpeza", "Abdullah Presheva", "Idriz Seferi", "Arben Ramadani", "Afrim Gagica", "Nazmi Hoxha", "Hamdi Kurteshi, "Beqir Musliu", "Binak Aliu", "Haqif Tetova", "Haxhi Salihu, "Zija Shemsiu", "Marie Shllaku", "Idriz Seferi", "Vëllezërit Gërvalla", "Nëna Terezë", "Ahmet Gashi".</p> <p>Nëntor: Fshatrat: Livoç i Ulët, Velekincë, Pasjan, Zhegër, Llovcë;</p> <p>Rrugët: "Vëllezërit Frashëri", "Beqir Musliu", "7 Shtatori", "Lidhja e Prizerenit", "Hanife Breisha", "Ali Hadri", "Idriz Seferi", "Mulla Idrizi", "Xhemajl Mustafa", "Abdullah Tahiri", "Dalip Dalipi", "Abdullah Presheva", "Afrim Zhitija", "Tefik Shehu", "Ibrahim Rugova", "Nëna Terezë".</p> <p>Dhjetor: Fshatrat: Përlepnice, Kmetovc, Malishevë, Livoç i Ulët, Velekincë, Pasjan, Zhegër, Llovcë.</p> <p>Rrugët: "Shadërvani", "Igballe Prishtina", "Bulevardi i Pavarsisë", "Xhevat Ajvazi", "Filip Shiroka", "Shaban dhe Sami Ukshini", "Arben Ramadani", "Kadri Halimi", "Alban Ajeti", "Abdullah Tahiri", "Bajram Llovca", "Haki Myderizi", "William Shekspir", "Vëllezërit Llozana", "Hasan Tasini", "Hysen Tërpeza", "Xhevat Ajvazi", "Zija</p> | Rrjedhje në rrugë (99) dhe rrjedhje në puseta (103). |

| | | | |
|------------------|----|--|--|
| | | Shemsiu", "Pajazit Ahmeti", "Gazmend Zajmi", "7 Shtatori", "Afrim Zhitija", "Elena Gjika". | |
| Novobërdë | 3 | Fshatrat: Tomancë, Makresh, Tullar. | Rrjedhje në rrugë (2) dhe rrjedhje në puseta (1). |
| Ranillug | 6 | Ranillug, Fshatrat: Ropotovë. | Rrjedhje në rrugë (3), rrjedhje në puseta (3). |
| Kamenicë | 64 | Tetor: Fshatrat: Shipashnicë e Epërme, Karaçevë e Poshtme, Topanicë, Koretin, Kopernicë. Rrugët: "Skënderbeu", "Kalabria", "Muli Imeri", "Hafiz Ali Korça", "Ismajl Ismajli", "Maliqi", "Iliria", "Epiri", "Muharremi i Hoxhës", "Sefë Kosharja", "Sahit Baliqi", "Kaçakët", "Hafiz Ali Korça", "Hasan Prishtina", "Vëllezrit Krivaça", "Shote Galica", "Adem Jashari", "Çamëria", "Musli Ymeri". Lagjeja "Malësia", "Abetarja", "Lot Vaku", dhe "Mihal Grameno". Nëntor: Fshatrat: Karaçevë e Poshtme, Topanicë, Shipashnicë e Epërme, Koretin, Kopernicë. Rrugët: "Adem Jashari", "Nexhmedin Korça", "Rexhep Hoti", "Sef Kosharja", "Dardana", "Hafiz Ali Korça", "Beteja e Ushit", "Besa e Kuçë", "Besnik Maroca", "Tahir Sinani". Dhjetor: Fshatrat: Karaçevë e Poshtme, Topanicë, Shipashnicë e Epërme, Koretin. Rrugët: "Skënderbeu", Rr. "Sahit Baliq", Rr. "Xhaxhi", Rr. "Fehmi Agani", Rr. "Hafiz Ali Korça", Rr. "Musli Ymeri", Rr. "Korfuzi". | Rrjedhje në rrugë (21), rrjedhje në pusetë të ujëmatësve (38), shkqyie nga rrjeti (5), verifikime (3) dhe zhvendosje e ujëmatësit (4). |
| Viti | 48 | Tetor: Fshatrat: Sadovinë e Jerlive dhe Sadovinë e Çerkezve. Rrugët: "Agim Ramadani", "Shota dhe Azem Galica". Nëntor: Fshatrat: Tërstenik, Ramnishtë, Pozhoran, Sadovinë e Qerkezëve. | Rrjedhje në rrugë (12), defekte në puseta (36). |

| | | | |
|----------------|------------|--|--|
| | | Dhjetor: Fshatrat: Letnicë, Pozhoran, Sadovinë e Çerezëve. | |
| Totali: | 323 | | |

Gjatë periudhës së tremujorit të katërt të vitit 2025, ndërprerje të ujit për shkak të defekteve në rrjetin e ujësjellësit ka pasur në lagjet/rrugët:

Tetor 2025:

- Në lagjen “Dardania 1&2” është ndalur uji rreth dhjet orë për shkak të defektit në gypin kryesor,
- Në Rrugën “Hysen Tërpeza” është ndalur uji rreth dymbëdhjet orë për shkak të defektit në gypin kryesor

Nëntor 2025:

- Në lagjen “Dardania 1” është ndalur uji rreth pesë orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në Rr. “Kodra e Dëshmorëve” është ndalur uji rreth katër orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
-
- Në Rr. “Besnik Maroca” (Kamenicë), është ndalur uji rreth një orë për shkak të defektit në gypin DN 5/4 PE;
- Në Rr. “Besa e Kuqe” (Kamenicë), është ndalur uji rreth një orë për shkak të defektit në gypin DN 5/4 PE;
- Në fshatin Kopërnice, është ndalur uji rreth një orë e gjysëm për shkak të defektit në gypin DN 5/4 PE.

Dhjetor 2025:

- Në fshatin “Zhegër” është ndalur uji rreth tre orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në Rrugën “Zija Shemsiu” është ndalur uji rreth katër orë për shkak të defektit në gypin kryesor.

***Shënim:** Për shkak të natyrës së punës të evitimit të rrjedhjeve, shumica e defekteve janë evituar në shtypje pa e ndalë ujin fare, këto raste janë kur defektet janë në profil të gypit të vogël ose kur nuk është i dëmtuar gypi shumë.*

8.3.1. DMA – zonat

Në zonën e shërbimit për regjionin e Gjilanit i kemi (6) gjashtë zona DMA:

1. Lagjen Dardania 1 dhe 2;
2. Livoç i Ulët;
3. Kufcë e Epërme;

4. Kmetovc dhe Verbiçë e Kmetovcit;
5. Shillovë e Muhaxherëve dhe

Zona më e madhe është ajo ku përfshihen Lagjet e Zabelit, Arbërisë, Velekınca dhe Bregu i Djegun.

Tabela 41. Analiza, prodhimi, faturimi dhe UPF, gjatë periudhës së TM4/2025 në DMA zonat për regjionin e Gjilanit

| | Burimi | Prodhimi (m ³) | Faturimi për (m ³) | UPF (%) |
|-----|---|----------------------------|--------------------------------|-------------|
| 1. | Rr. "Lidhja e Prizrenit" *10 | 75,600 | | |
| 2. | Lagjja "Bregu i Djegun" (te ishi kombinati i duhanit) | 15,854 | | |
| 3. | Rr. "Hysen Tërpeza" | 15,299 | | |
| 4. | Lipovicët | 17,113 | 121,125 | 44.76 |
| 5. | Mbrapa shkollës në Velekincë DN 63 | 1,272 | | |
| 6. | Velekincë DN 90 | 18,834 | | |
| 7. | Rr. "Mulla Idrizi" | 71,000 | | |
| 8. | Rr. "Esat Berisha" *10 | 4,300 | | |
| 9. | Shillova 1 | 832 | 1,489 | 37.28 |
| 10. | Shillova 2 | 1,542 | | |
| 11. | Kmetove | 12,310 | 10,239 | 16.82 |
| 12. | Kufcë e Epërme | 7,825 | 4,033 | 48.46 |
| 13. | Livoç i Ulët | 31,290 | 14,557 | 53.48 |
| 14. | Lagjja "Dardania 1" *10 | 49,920 | 51,592 | 44.1 |
| 15. | Lagjja "Dardania 2" *10 | 42,390 | | |
| | Prodhimi total m³/TM4 | 346,481 | 203,035 | 41.4 |

Në zonën e shërbimit për regjionin e Kamenicës kemi një zonë DMA:
Berivojcë – Lagjja Iliria

Në zonën e shërbimit për regjionin e Vitisë i kemi dy zona DMA:
1. Pozhorani
2. DMA Zonë mbrenda qytetit të Vitisë.

8.4. Mirëmbajta e rrjetit të kanalizimit

Gjatë periudhës së tremujorit të katërt të vitit 2025, në rrjetin e kanalizimit kanë qenë gjithsej: 437 intervenime duke përfshirë Njësitë Operative në Gjilan, Kamenicë dhe Viti.

Tabela 42. Numri i intervenimeve në rrjetin e kanalizimit gjatë periudhës së TM4/2025

| Njësia | Numri i intervenimeve | Përshkrimi |
|---------------|-----------------------|---|
| Gjilan | 5 | Vendosje e kapakëve të pusetave |
| | 13 | Intervenime me autocisternë |
| | 2 | Vendosje e unazave |
| | 2 | Vendosje e konusave |
| | 359 | Debllokime kanalizimi dhe pastrimi i pusetave |
| Viti | 52 | Debllokime kanalizimi dhe pastrim i pusetave |
| Novobërdë | / | Debllokime kanalizimi dhe pastrimi i pusetave |
| Partesh | / | Debllokime kanalizimi dhe pastrimi i pusetave |
| Kamenicë | 65 | Debllokime kanalizimi dhe pastrimi i pusetave |
| Total: | 498 | |

Gjatë kësaj periudhe gjithashtu, në Nj.O. në Gjilan, kemi pasur (10) intervenime me autocisternë si dhe (13) vendosje të kapakëve në puseta të kanalizimeve.

Tabela 43. Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit gjatë periudhës së TM4/2025 në Gjilan

| Muaji | Gjatësia e rrjetit të kanalizimit (km) |
|---------------|--|
| Tetor | 18.69 km |
| Nëntor | 15.8 km |
| Dhjetor | 14.04 km |
| TOTALI | 48.53 km |

8.5 Divizioni për planifikim dhe menaxhim të projekteve

8.5.1. Aktivitetet e realizuara gjatë tremujorit të katërt të vitit 2025

Gjatë periudhës së tremujorit të katërt të vitit 2025, Divizioni për Planifikimin dhe Menaxhimin e Projekteve ka realizuar aktivitetet e paraqitura në tabelën më poshtë:

Tabela 44. Aktivitetet e realizuara nga DPMP gjatë periudhës së TM4/2025

| | Aktivitet | Numri i aktiviteteve |
|----|---|----------------------|
| 1. | Pëlqime në parim për banime kolektive dhe afarizëm | 9 |
| 2. | Pëlqim në parim për banim individual | 23 |
| 3. | Pëlqim në parim për institucione | 4 |
| 4. | Evidentimi i intervenimeve në GIS | 111 |
| 5. | Insertimin e kërkesave të reja për kyçe në rrjetin e ujësjellësit | 80 |
| 6. | Vlerësim të ofertave në Prokurim | 8 |
| 7. | Menaxhim dhe mbikëqyerje të kontratave | 12 |
| 8. | Inçizimi i rrjetit të kanalizimit fecal (puseta) | 151 |

Përveç këtyre aktiviteteve të paraqitura në tabelë, zyrtarët nga Divizioni i Planifikimit janë të angazhuar edhe në tri projekte të rëndësishme në zhvillimin e kompanisë siç janë:

8.5.2 Projekti FLOWS (Nxitja dhe Shfrytëzimi i Mundësive për Sigurinë e Ujit)

Gjatë periudhës së tremujorit të katërt të vitit 2025, janë evidentuar përparime të dukshme në zbatimin e projektit FLOWS, të reflektuara përmes intensifikimit të aktiviteteve ndërtimore dhe instalimeve teknike në disa komponentë kyç të projektit. Punimet në rezervuarin e Përlepnicës kanë vijuar pa ndërprerje, ku përveç instalimit të rrjetit të ujësjellësit, është avancuar përgatitja e armaturës së pllakës për betonim, si dhe janë realizuar punime të hidroizolimit, duke siguruar një bazë të qëndrueshme për fazat pasuese të ndërtimit. Paralelisht, ndërtimi i rezervuarit me kapacitet 3.500 m³ po zhvillohet në përputhje me planin dinamik të miratuar të projektit.

Në kuadër të rrjetit të shpërndarjes, është përfunduar shtrirja e gypit DN 350 PE në rrugën Hamdi Kurteshi, ndërsa në fshatin Përlepnicë kanë vazhduar punimet për shtrirjen e gypit DN 630 PE. Në Linjën 1, seksioni A, është përfunduar afërsisht dy të tretat e segmentit të planifikuar të gypit DN 630 mm, duke përfshirë instalimin e 260 metrave shtesë gjatë muajit dhjetor. Po ashtu, në Linjën 2B janë instaluar 350 metra gyp DN 315 mm, duke rritur ndjeshëm mbulimin dhe funksionalitetin e rrjetit të shpërndarjes.

Sa i përket komponentës teknologjike, është realizuar instalimi i pajisjeve për monitorimin SCADA, ndërsa aktualisht është në zhvillim procesi i konfigurimit të komunikimit për funksionalizimin e plotë të sistemit. Në stacionin e pompimit në Velekincë, janë zëvendësuar pompat ekzistuese, si dhe janë instaluar pajisje dhe komponentë përcjellës elektrikë, çka ka rezultuar në rritje të kapacitetit dhe përmirësim të ndjeshëm të

besueshmërisë operacionale të sistemit.

Gjatë periudhës së tremujorit të katërt të vitit 2025, është mbajtur gjithashtu takimi mujor i progresit për Pakon 2 (Letnicë dhe ndërimi i gypave në Kamenicë), me pjesëmarrjen e të gjitha palëve relevante, ku janë shqyrtuar ecuria e punimeve, sfidat e evidentuara dhe janë përcaktuar hapat e mëtejshëm për implementim të suksesshëm të projektit.

8.5.3 Projekti ITUN (Impianti i Trajtimit të Ujrave të Zeza)

Gjatë periudhës së tremujorit të katërt të vitit 2025, në kuadër të projektit ITUN, aktivitetet janë përqendruar kryesisht në aspektet përgatitore administrative dhe ligjore, si dhe në iniciimin e punimeve në terren. Gjatë kësaj periudhe ka vijuar përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për pajisje me leje ndërtimore për kolektorët, ku në kuadër të procedurave ligjore janë vendosur tabelat njoftuese përgjatë trasës së kolektorëve, në përputhje me kërkesat për marrjen e kushteve ndërtimore. Njëkohësisht, është finalizuar raporti për lejen mjedisore komunale dhe është dorëzuar aplikimi përkatës pranë autoriteteve relevante.

Në fushën e prokurimit, është lansuar tenderi “Stage 2” për ndërtimin e ITUZ, ndërsa paralelisht ka filluar procesi i vlerësimit për fazën e dytë të ndërtimit të ITUN. Gjatë kësaj periudhe është harmonizuar dhe nënshkruar Amendamenti Nr. 1 i kontratës për mbikëqyrjen e punimeve. Po ashtu, është mbajtur takimi fillestar (kick-off meeting) me kontraktorin dhe mbikëqyrjen, gjatë të cilit janë përcaktuar detyrat, dinamika e zbatimit dhe mekanizmat e koordinimit ndërmjet palëve.

Në fillim të muajit dhjetor është caktuar data e fillimit, duke shënuar zyrtarisht fillimin e punimeve në terren për rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit të kanalizimit. Kontraktori është mobilizuar në terren dhe ka filluar realizimin e punimeve në përputhje me planin e miratuar, ndërkohë që janë siguruar edhe lejet ndërtimore përkatëse nga Komuna e Gjilanit.

Ndërkohë, është në proces përpilimi i paramasës, parallogarisë, detajeve teknike, si dhe përgatitja e dosjes së tenderit për projektin “Ndërtimi i pusetave për DMA – Viti”. Po ashtu, paramasa dhe parallogaria për rrugët me nivel të lartë kritikaliteti sipas PMA janë aktualisht në fazë përgatitore.

Kryesues i Bordit të Drejtorëve
KRU “Hidromorava” Sh.A. Gjilan


z. Habil Zeqiri

